



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 20 Prill 2021

Nr: 253

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj kandidatit për deputet z. Petrit Malaj.

Kërkues: Partia Demokratike, Dega Tropojë

Ndaj: Z. Petrit Malaj, kandidat për deputet, Qarku Kukës

Baza ligjore: Nenet 19, paragrafi 1, shkronjat “dh”, “f” dhe ‘n”, paragrafi 2, dhe 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 44, 77 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:



I

Vlerësimi paraprak

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është raportuar një denoncim në ndërfaqen e “Aktiviteteve të Ndaluar”, në rubrikën “Kallëzo”, nga subjekti politik Partia Demokratike, Dega Tropojë, për veprimtarinë z. Petrit Malaj, i cili në faqen e tij të facebook ka shpërndarë materiale, që bien në kundërshtim me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Në denoncimin e raportuar më datë 25.03.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 2466 ora 12:26, në ndërfaqen e KQZ-së pretendohet se: *“Veprime dhe aktivitete të kandidatit për deputet të subjektit zgjedhor Partia Socialiste, z. Petrit Malaj, në kundërshtim me vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, neni 3, pika 1.1, shkronja “b”, “ç” dhe “d”, kandidati për deputet i partisë Socialiste të Shqipërisë, z. Petrit Malaj, ka shpërndarë në faqen zyrtare të tij në datën 24.03.2021 një material, ku vërehet se po përdor për ndikim dhe publicitet të fushatës s tij zgjedhore, fondet publike të AZHBR-së, financime të projekteve bujqësore. Këto fonde publike identifikohen nën siglën e Partisë Socialiste, në suport të njëanshëm për fushatën e tij elektorale”.*

Bashkangjitur denoncimit, si provë për është dërguar postimi i z. Petrit Malaj në të cilin ai shprehet se deklaroi:

“Të dashur Tropojanë, Kuksianë e Hasianë!

Nga sot hapet aplikimi për mbështetje financiare për fermerët;

1. Përfiton cilido që ka mbi 5 lopë të matrikulluara / 10000 lekë për lopë;

2. Përfiton cilido që ka mbi 70 dele apo dhi të matrikulluara / 1200 lekë për bagëti;

3. Përfiton cilido që ka 50 koshere e lart/ 1000 lekë për koshere;

4. Përfiton cilido që do të zëvendësojë plastmasin e serës/ 300000 lekë për hektar për perime, 100000 lekë për hektar për rrush tavoline, 500000 lekë për hektar për tunelet e luleshtrydheve;



5. Përfiton cilido që mbjell e kultivon bimë medicinale individualisht në 2 dynym e lart/ 200000 lekë për hektar e deri në 100.000 lekë maksimalisht.

#ShqipëriaeArdhmjaJonë

#SkaKohëPërPushim

APLIKONI SOT

Në çdo njësi administrative ju pret një njeri për t'ju ndihmuar të aplikoni online, tani!

Pjesë e postimit janë dhe disa fotot shoqëruese.

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, paragrafi 2, dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;

f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;

n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Duke qenë se denoncimi lidhet me deputetin z. Petrit Malaj, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, konstaton se deputeti nuk përfshihet në rrethin e subjekteve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 3 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të fillojë një procedurë administrative të kërkuar nga denoncuesi për shkak të mungesës së kompetencës ndaj subjektit.

II.

Rrethanat e faktit

Komisioni Rregullator në KQZ, më datë 24.12.2020, ka miratuar vendimin nr. 9 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve

shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Ky akt normativ ka hyrë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij dhe është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së në datë 26.12.2020.

Gjithë të interesuarit mund të disponojnë përmbajtjen e tij nëpërmjet faqes zyrtare të KQZ-së, në rubrikën “Vendime” dhe kategorinë “Vendime të Rregullatorit” duke filluar nga kjo datë.

Në denoncimin e raportuar më datë 25.03.2021 , me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 2466 ora 12:26, në ndërfaqen e KQZ-së pretendohet z. *Petrit Malaj ka kryer aktivitete që bien në kundërshtim me vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.*

Nga verifikimi i kryer, rezultoi se me vendimin nr. 146 datë 16.03.2021 “Për miratimin e listave shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”, të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, z. Petrit Malaj është kandidat për deputet në zonën zgjedhore, Qarku Kukës.

III.

Analiza ligjore

Neni 3, paragrafi 2, i vendimit nr. 9/2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, të Komisionit Rregullator ka përcaktuar rrethin e subjekteve të cilët ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi sipas përcaktimit të mëposhtëm:

“Kryeministri, administrata e tij, Zëvendëskryeministri, ministri dhe zëvendësministri, administrata e tyre, kryetari i bashkisë zëvendësit dhe administrata e tij, Prefekti dhe administrata e tij, drejtori i përgjithshëm i agjencive apo institucioneve në varësi të Kryeministrit, Këshillit të Ministrave ose Ministrit, drejtori i përgjithshëm, drejtorët e departamenteve, drejtorët e drejtorive dhe administratat respektive, drejtuesit dhe anëtarët e organeve kolegjiale, enteve, bordeve, çdo drejtues i shoqërive tregtare në administrim nga shteti si edhe në çdo ent ku shteti zotëron aksione e kapitale/kuota apo emëron shumicën e organit

mbikëqyrës ose të organit administrues, titullari dhe zëvendësit e tij për ndërmarrjet shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdolloj forme, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se, z. Petrit Malaj është kandidat për deputet për Partinë Socialiste të Shqipërisë, Qarku Kukës, por referuar nenit 3, paragrafi 2 të vendimit nr. 9/2020, kandidati për deputet nuk përfshihet në rrethin e subjekteve që “*gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdolloj forme, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi”.*

Përsa i përket postimit në llogarinë e kandidatit për deputet në facebook, referuar vendimit nr. 4, datë 22.01.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, **ky postim nuk e bën veprimtarinë publike.** “*Postimi dhe veprimtaria janë dy ngjarje të dallueshme qartë nga njëra tjetra dhe të zhvendosura në kohë. Nga ana tjetër, facebook-u apo media të tjera sociale nuk bëjnë pjesë në kategorinë “media” që kërkon pika 1 e nenit 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Dispozita kërkon “pjesëmarrje” të medias, që t’u konsiderojë veprimtarinë publike”.* Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vlerëson se postimi në facebook, nuk përbën shkelje të nenit 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi nuk ndodhemi para rastit të përdorjes së burimeve publike të AZHBR-së në mbështetje të fushatës së tij zgjedhore.

Referuar denoncimit të mësipërm, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të nisë një procedurë administrative, pasi subjekti, rrethanat dhe faktet e paraqitura në këtë denoncim nuk futen në fushën e zbatimit të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronjat “dh”, “f”, “n”, paragrafi 2, 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,



V E N D O S:

1. Mosfillimin e procedurës administrative për shkak se subjekti, rrethanat dhe faktet e paraqitura në këtë denoncim nuk futen në fushën e zbatimit të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Iirjan CELIBASHI

